

**VENDIM**  
**Nr. 832, datë 3.12.2014**

**PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE**  
**SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË**  
**SEKTORËT JOSTRATEGJIKË<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.346, datë 12.6.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha shoqëritë tregtare me kapital tërësisht apo pjesërisht shtetëror, që veprojnë në sektorët jostrategjikë, te të cilat do të shiten paketat shtetërore të aksioneve. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për fillimin e procedurave të privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve, pasi shoqëria të jetë vlerësuar dhe të ketë përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për shitjen e këtyre paketave. Vlerësimi i shoqërisë dhe përgatitja e dokumentacionit të privatizimit bëhen në zbatim të urdhrit të *ministrit të Financave dhe Ekonomisë*, në përputhje me udhëzimin përkatës që do të hartohet në zbatim të këtij vendimi.

2. *Dokumentacioni i privatizimit i përgatitur nga ekspertët vlerësues përmban:*

- a) urdhrin e *ministrit të Financave dhe Ekonomisë* për fillimin e procedurave të privatizimit;
- b) aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë;
- c) vendimin e regjistrimit të shoqërisë si person juridik në gjykatë dhe/ose në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me ndryshimet e bëra në të;
- ç) bilancin e fundit ushtrimor të shoqërisë;
- d) raportin e ekspertit kontabël;
- dh) raportin e ekspertëve për vlerësimin e shoqërisë;
- e) genplanin apo planvendosjen e shoqërisë, të konfirmuar nga institucioni i prefektit;
- ë) aktvlerësimin e truallit të shoqërisë;
- f) vërtetimin nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve për regjistrimin e shoqërisë që privatizohet, kur shoqëria ka mbi 50 aksionarë;
- g) aktin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të shoqërisë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, së bashku me hartën treguese.

2.1. *Dokumentacioni i privatizimit, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar në urdhrin e ministrit, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, i dërgohet Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, të krijuar me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, për verifikimin, konfirmimin dhe transparencën e procedurave të vlerësimit dhe hartimit të dokumentacionit për paketat shtetërore të aksioneve që dërgohen për shitje/privatizim;*

2.2. *Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës i rekomandon ministrit përgjegjës për ekonominë vijimin e procedurës së privatizimit nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nëse ekziston*

---

<sup>1</sup> VKM nr. 832, datë 3.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 190, datë 16 dhjetor 2014.  
VKM nr.346, datë 12.6.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 19 qershor 2018.

*dokumentacioni i kërkuar ligjor dhe ka kaluar në të gjitha strukturat e parashikuara në këtë vendim.*

*Në rast të kundërt, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës kërkon plotësimin e dokumentacionit.*

3. *Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbërritjes së dokumentacionit, shqyrton rregullsinë e tij. Kur në dokumentacionin e dërguar vërehen parregullsi të kërkesave të pikës 2, të këtij vendimi, drejtoria e sipërpërmendur e kthen atë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për plotësim.*

4. Me publikimin e shoqërisë për fillimin e procedurave të privatizimit, asaj i ndalohet të bëjë çdo ndryshim kapitali, të marrë hua apo kredi.

## I. PROCEDURAT PËR PËRCAKTIMIN E FORMULËS SË PRIVATIZIMIT

### A. Publikimi

1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, fillon menjëherë publikimin. Periudha e publikimit zgjat 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Data e parë e publikimit të jetë data e përcaktuar në njoftimin, që kjo drejtori dërgon për publikim. Brenda periudhës së publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, kjo drejtori dërgon për publikim të dhënat për shoqëritë që privatizohen edhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare. Krahas këtij publikimi bëhen njoftime në internet. Në internet (faqja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) njoftohen edhe treguesit ekonomikë e teknikë të shoqërisë (llogaritë vjetore).*

Kjo procedurë zbatohet në të gjitha rastet e publikimit për shitje të paketave të aksioneve shtetërore.

2. Publikimi përmban këto elemente:

a) Emrin e shoqërisë tregtare;

b) Selinë e shoqërisë;

c) Kapitalin e vlerësuar dhe numrin e aksioneve të shoqërisë tregtare;

ç) Sipërfaqen e truallit të shoqërisë, nën objekt dhe funksionale;

d) Objektin e veprimtarisë;

dh) Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve, që punonjësit e shoqërisë duhet të dorëzojnë pranë shoqërisë;

e) Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve, që punonjësit e shoqërisë duhet të dorëzojnë në *strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,*

ë) Afatin e regjistrimit dhe llojin e dokumenteve që ish-pronarët e truallit duhet të dorëzojnë në *strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.*

3. Brenda periudhës së publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, vendos publikim me afishim me të dhënat e publikuara për këto shoqëri në mjediset e saj, ndërsa degët e shoqërive publike në prefektura vendosin afishe me të dhënat e publikuara për këto shoqëri pranë shoqërive, që privatizohen dhe në mjediset publike të vendndodhjes së shoqërisë.*

4. Në fund të periudhës së publikimit, degët e shoqërive publike në prefektura mbajnë një procesverbal për vendosjen pranë shoqërive të publikimit me afishim me të dhënat e publikuara dhe mbylljen e publikimit.

### B. Procedurat e llogaritjes së paketës së aksioneve për punonjësit e shoqërisë

1. Punonjësit e shoqërisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e parë e publikimit nga *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duhet të paraqesin pranë shoqërisë certifikatën e gjendjes familjare, lëshuar nga zyra e gjendjes civile pas datës së publikimit, me anë të së cilës përcaktohen anëtarët që përfitojnë bono privatizimi.*

2. Shoqëria lëshon vërtetimin për identitetin e punonjësit, periudhën e punësimit ose datën e daljes së tij në asistencë për trajtimin me pagesë papunësie.

3. Shoqëria, në bazë të këtij dokumentacioni, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga data e publikimit për fillimin e procedurës së privatizimit, i dërgon *strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e*

*Financave dhe Ekonomisë*, të dhënat, sipas formularëve të përcaktuar prej kësaj të fundit.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e publikimit të fundit, punonjësit e shoqërisë bëjnë regjistrimin e kërkesave për zotërim aksionesh në këmbim të bonove të privatizimit në *strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, dhe degët e thesarit në rrethe, në bazë të përcaktimeve të pikave 1, 2 dhe 3, të shkronjës “B”, të kreut I, të këtij vendimi.

5. Punonjësit e shoqërisë kanë të drejtë të shkëmbejnë, me vlerë nominale, bonot e privatizimit të tyre dhe ato të familjes në aksione të shoqërisë. Pjesëmarrja e punonjësve në aksione të shoqërisë do të llogaritet si raport ndërmjet vlerës së bonove familjare të privatizimit, të dorëzuara, të cilat ata i zotërojnë sipas legjislacionit në fuqi (dekreti nr.1030, datë 1.11.1996, ndryshuar me akte të tjera ligjore), dhe kapitalit themeltar të shoqërisë. Përqindja e aksioneve të tyre mbetet e pandryshuar në raport me pjesën tjetër, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.

6. Punonjës të shoqërisë konsiderohen punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me asistencë, sipas ligjit nr.7521, datë 30.10.1991, “Për përkrahjen sociale për personat që dalin pa punë nga zbatimi i reformës ekonomike”, të ndryshuar, një vit para publikimit të fillimit të procedurave të privatizimit për shoqërinë.

Dokumentet, afatet dhe kërkesa të tjera lidhur me llogaritjen e paketës së aksioneve për punonjësit e shoqërisë përcaktohen në udhëzimin përkatës që do të hartohet në zbatim të këtij vendimi.

C. Procedurat për llogaritjen e paketës së aksioneve për ish-pronarët e truallit

1. Ish-pronarët e truallit, si subjekte kërkuese, në dallim nga subjektet e tjera kërkuese, në mbështetje të ligjit nr. 133/ 2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar, për vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet, në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuara në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda kufizimit të shoqërisë.

2. Pjesëmarrja në aksione të shoqërisë për ish-pronarët e truallit do të llogaritet si raport ndërmjet vlerës së truallit të llogaritur për ish-pronarët dhe kapitalit themeltar të shoqërisë.

3. Ish-pronari i truallit, për vlerën e truallit si pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë, nuk merr pjesë në ankandin e aksioneve. Ai zotëron një përqindje të caktuar të aksioneve, e cila mbetet e pandryshuar në raport me pjesën tjetër të kapitalit të shoqërisë, pavarësisht nga rezultatet e ankandit.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e parë e publikimit, ish-pronarët e truallit duhet të paraqesin në *strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, në origjinal:

a) kërkesën me shkrim për zotërim aksionesh në kapitalin e shoqërisë që privatizohet, në përpjesëtim me vlerën e truallit që atij i njihet nga vendimi përkatës i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;

b) vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, së bashku me planvendosjen e pronës së hartuar nga ky komision, kopje të noterizuar;

c) dëshminë e trashëgimisë dhe prokurën e përfaqësimit origjinal;

ç) një vërtetim nga *Agjencia e Trajtimin të Pronës* dhe deklaratën noteriale, ku të konfirmohet dhe të deklarohet se për sipërfaqen e truallit, ish-pronë e tij, që ish-pronari kërkon të kompensohet me aksione në shoqërinë përkatëse, nuk është kompensuar më parë me njërin nga format që njej ligji.

5. *Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, konfirmon pranë *Agjencisë së Trajtimin të Pronës* vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave bashkë me planvendosjen e pronës të depozituar nga ish-pronarët e truallit, e cila duhet të kthejë përgjigje brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës së *strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës*.

Ç. Formula e privatizimit

1. *Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga degët e thesarit në rrethe dhe ish-pronarët e truallit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e fundit e regjistrimit të kërkesave për zotërim aksionesh, bën sistemimin e tij

dhe kryen llogaritjet për pjesët e kapitalit të shoqërisë që përbëjnë paketat e aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit.

2. Në përfundim të llogaritjeve, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, nxjerr:

a) rezultatin e kërkesës për aksione të shoqërisë për secilin punonjës dhe për çdo anëtar të familjes së tyre, në këmbim të bonove të privatizimit;

b) rezultatin e porositjes së aksioneve të shoqërisë për ish-pronarët e truallit;

c) rezultatin përfundimtar të llogaritjeve për pjesën e kapitalit themeltar të shoqërisë, që përbën paketën e aksioneve për punonjësit e shoqërisë e për ish-pronarët e truallit, të cilin ia dërgon *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*.

3. Ministri përgjegjës për ekonominë, pas marrjes së rezultatit përfundimtar nga *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, nxjerr urdhrin për transferimin e paketave të aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe për pronarët e truallit, të cilin ia dërgon Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve dhe shoqërisë për të kryer veprimet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas regjistrimit në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve dhe Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, *ministra i Financave dhe Ekonomisë* përcakton paketën e aksioneve shtetërore për privatizim, për të cilën kërkon mendimin e organit që ka shoqërinë në varësi administrative.

5. Pas marrjes së mendimit për privatizim, *ministri i Financave dhe Ekonomisë* nxjerr urdhrin e privatizimit të paketës dhe e dërgon në *strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*.

6. Në çdo rast, pjesë e urdhrit të ministrit përgjegjës për ekonominë janë edhe të dhënat për shitjen e paketës së aksioneve, në përqindje, vlera e paketës së aksioneve, numri i aksioneve që shiten, forma e procedurës së privatizimit dhe mënyra e pagesës së vlerës së paketës së aksioneve.

7. Në qoftë se procedurat e llogaritjes së aksioneve të punonjësve të shoqërisë dhe të ish-pronarëve të truallit nuk realizohen, atëherë ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë, pa u mohuar atyre të drejtën për aksione me një publikim të dytë.

8. Në shoqëritë tregtare, kur ka të dhëna të plota për pjesën e aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe për ish-pronarët e truallit, *ministri i Financave dhe Ekonomisë* ka të drejtë të përcaktojë paketën e aksioneve, që i ofrohet blerësit të vetëm, dhe nxjerr urdhrin përkatës për privatizim.

Procedurat për formulën e privatizimit përcaktohen në udhëzimin përkatës që do të hartohet në zbatim të këtij vendimi.

## II. PROCEDURAT PËR PRIVATIZIMIN E PAKETAVE TË AKSIONEVE

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së urdhrit të *ministrit të Financave dhe Ekonomisë*, (pika 5, e shkronjës “Ç”, tëkreat I), *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, fillon procedurën e publikimit për shitjen e paketës së aksioneve, si dhe njofton aksionarët e shoqërisë për datën dhe orën e zhvillimit të ankandit. Afati i publikimit është 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit të parë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe bëhet në çdo botim të tij, brenda këtij afati. Data e parë e publikimit të jetë data e përcaktuar në njoftimin, që *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, dërgon për publikim. Brenda periudhës së publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, kjo drejtori dërgon për publikim të dhënat për shoqëritë që privatizohen edhe në dy gazeta me qarkullim kombëtar, nga një botim në secilën gazetë, si dhe në degën e shoqërive publike në prefekturën përkatëse, e cila vendos publikimin me afishe me të dhënat e botuara për shoqëritë që privatizohen në ambientet e shoqërisë dhe mjediset publike të vendndodhjes së shoqërisë. Gjithashtu, brenda periudhës së publikimit bëhen njoftime në televizion dhe internet (faqja e *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*) deri në fund të periudhës së publikimit.

Dega e shoqërive publike në prefekturën përkatëse mban procesverbal për vendosjen pranë shoqërive të afisheve me të dhënat e publikuara dhe e dërgon në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*.

Objekt publikimi janë:

- a) emri i shoqërisë;
- b) selia;
- c) kapitali i vlerësuar dhe numri i aksioneve të shoqërisë;
- ç) paketa e aksioneve që privatizohen;
- d) vlera e paketës së aksioneve;
- dh) objekti i veprimtarisë;
- e) sipërfaqja e truallit të shoqërisë;
- ë) data, ora dhe vendi i zhvillimit të ankandit.

2. Pjesëmarrësit në ankand, gjatë periudhës së publikimit, kanë të drejtë të njihen me dosjen e shoqërisë, e cila ndodhet në *strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*. Gjithashtu, ata mund të marrin informacion në shoqërinë që privatizohet. Pjesëmarrja në ankand, pa u njohur me dosjen e shoqërisë, është në përgjegjësinë e subjekteve pjesëmarrëse.

A. Paketa e aksioneve që i ofrohet me ankand blerësit të vetëm

1. Paketa e aksioneve, që i ofrohet me ankand blerësit të vetëm, shitet në lekë.
2. Pjesëmarrësit në ankandin e paketës së aksioneve, të ofruar blerësit të vetëm për privatizim, paraqesin para komisionit të ankandit dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën me shkrim për pjesëmarrje në privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë.
- b) Dokumentet ligjore, identifikuese, të personave fizikë ose juridikë.
- c) Dokumentin bankar të pagesës (vetëm nëpërmjet bankave) paraprake me lekë, mandatarkëtimin, urdhërxhirimin apo garancinë bankare në lekë për 30-përqindshin e vlerës së paketës së aksioneve, në favor të *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*.

3. Komisioni i ankandit ka në përbërje:

- a) përfaqësuesin e *strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, kryetar;
- b) juristin e *strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, anëtar;
- c) përfaqësuesin e *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ekonominë* anëtar;
- ç) përfaqësuesin e shoqërisë tregtare që privatizohet anëtar;
- d) përfaqësuesin e organit administrativ të linjës anëtar;
- dh) punonjësin e *strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës*, pa të drejtë vote, sekretar.

4. Titullarët e organeve të përmendura në pikën 3, të shkronjës “A”, të kreut II, të këtij vendimi, ngarkohen me përgjegjësi për mospjesëmarrjen e anëtarëve të komisionit të ankandit në datën dhe në orën e caktuar për zhvillimin e ankandit.

5. Komisioni i ankandit merr vendime të vlefshme me votat e jo më pak se tre anëtarëve të vet. Kur nuk sigurohet pjesëmarrja e plotë e anëtarëve të komisionit, ankandi zhvillohet, por jo me më pak se tre anëtarë komisioni, me të drejtë vote. Në këtë rast, vendimi i anëtarëve të komisionit duhet të jetë unanim. Kryetari ka të drejtën e dy votave, në rast barazimi votash. Në rast të mosplotësimit të komisionit të ankandit si më sipër, atëherë anëtarët e pranishëm në komision, në prani të pjesëmarrësve në ankand i propozojnë drejtorit të Drejtimit të Pronës Publike shtyrjen e ankandit për një periudhë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit dhe, me miratimin e këtij të fundit, kërkohet plotësimi i komisionit të ankandit në institucionet përkatëse.

6. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- a) Të regjistrojë dhe të identifikojë, sipas dokumenteve të përcaktuara në ligj, dhe të nënshkruajë me secilin pjesëmarrës marrëveshjen për kushtet për privatizimin e paketës së aksioneve.
- b) Të paraqesë anëtarët e komisionit të pjesëmarrësit;
- c) Të deklarojë vlerën fillestare të ankandit;
- ç) Të drejtojë marrjen e ofertave;
- d) Të hartojë dokumentacionin për ecurinë e ankandit, që përbëhet nga procesverbali dhe raporti për përfundimin e ankandit. Ky dokumentacion nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të

ankandit dhe nga fituesi i tij.

7. Fituesi i ankandit shpallet deklaruesi i çmimit më të lartë.

8. Pjesëmarrësi që ka ofruar çmimin më të lartë (fituesi i ankandit) merr nga *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, autorizimin për pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve të publikuara për shitje sipas çmimit të arritur në ankand, ku përcaktohen kushtet që duhen plotësuar nga pala blerëse para nënshkrimit të kontratës së shitjes.

9. Në autorizimin për kalim pronësie përcaktohet se fituesi i ankandit është i detyruar të bëjë pagesën e plotë të vlerës së paketës së aksioneve në lekë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të ankandit.

Pjesëmarrësve të tjerë në ankand u kthehet vlera fillestare prej 30 për qind, vlerë kjo e parapaguar për pjesëmarrje në ankand.

10. Fituesit të ankandit, që nuk kryen pagesën e plotë brenda afatit të përcaktuar në pikën 9, të këtij kreu, si dhe në rastet kur ai tërhiqet brenda këtij afati, i mbahet vlera fillestare e paguar paraprakisht për pjesëmarrje në ankand, si e ardhur në buxhet. Në vazhdim, procedura rifillon sipas përcaktimit të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi.

11. Vetëm kur blerësi plotëson kushtet e autorizimit, sipas pikës 9, të shkronjës “A”, të kreut II, drejtori i *strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, lidh me palën blerëse kontratën e shitjes së aksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pagesës së vlerës së plotë të paketës së aksioneve, të publikuara për shitje.

12. Në rast se në ankandin e shpallur nga *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, nuk ka asnjë pjesëmarrës, kjo drejtori bën edhe një publikim të dytë për shitjen e paketës së aksioneve, sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi. Në rast se edhe pas publikimit të dytë në ankand nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës* njofton *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, duke kthyer dokumentacionin e vlerësimit, të cilin ministria e vë në dispozicion të *Agjencisë e Trajtimit të Pronës* për të kompensuar subjektet e shpronësuara.

13. Në rast se në ankandin për shitjen e paketës së aksioneve shtetërore, që i ofrohet blerësit të vetëm, ka vetëm 1 (një) kërkesë, e cila regjistrohet, por nuk shpallet fituese e ankandit, atëherë bëhet edhe një botim tjetër për një periudhë 10-ditore, nga një herë në dy gazeta me qarkullim kombëtar. Pas këtij afati, në rast se ka kërkesa të tjera për blerjen e kësaj pakete, ato konkurrojnë me kërkesën e parë, të regjistruar para 10 (dhjetë) ditëve, në të kundërt kërkesa e vetme shpallet fituese e ankandit.

Procedura lidhur me procesverbalin e përfundimit të publikimit, kontrollin e dokumentacionit të paraqitur, procesverbalin e zhvillimit të ankandit, deri në hartimin e raportit për përfundimin e ankandit përshkruhet në udhëzimin përkatës që do të hartohet në zbatim të këtij vendimi.

B. Paketa e aksioneve për publikun

1. Procedurat e shitjes së paketës së aksioneve për publikun fillojnë me publikimin, sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi.

2. Procedurat e shitjes së paketës së aksioneve për publikun fillojnë me publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike. Afati i publikimit është 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit të parë dhe bëhet në çdo botim të këtij buletini, brenda këtij afati. Data e parë e publikimit është data e përcaktuar në njoftimin që *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, dërgon për publikim brenda periudhës së publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Kjo drejtori vendos njoftime në mjediset e saj me të dhënat e botuara për shoqëritë që privatizohen.

3. Regjistrimi i porosive për aksione të shoqërisë, me bono dhe lekë privatizimi, zgjat jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë.

4. Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të porositin aksione për çdo shoqëri tregtare, të shpallur për shitje, njëkohësisht në qendrën e ankandit pranë *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, pavarësisht nga vendndodhja e shoqërisë tregtare.

5. Të paktën brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e mbylljes së ankandit, *struktura përgjegjëse për*

*shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përpunon dhe nxjerr rezultatin përfundimtar për secilin pjesëmarrës në ankand. Mënyra e shpërndarjes së kapitalit të paketës së aksioneve për publikun do të jetë në përpjesëtim, sipas rezultateve përfundimtare të raportit kërkesë-ofertë.*

6. Përfundimi i periudhës së regjistrimit shënon edhe përfundimin e privatizimit të paketës së aksioneve për publikun.

Në rast se do të rezervohet një paketë aksionesh për publikun, procedurat e privatizimit të kësaj pakete do të përcaktohen me udhëzim të veçantë.

C. Privatizimi i paketës së aksioneve shtetërore në shoqëritë pjesërisht të privatizuara

1. Në shoqëritë, ku paketa shtetërore është nën 50 për qind të aksioneve, në bazë të dokumentacionit që ka *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, pasi të jetë zbritur për qindja e aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe për punonjësit e shoqërisë, shitja e pjesës së mbetur të paketës së aksioneve, në favor të aksionarëve të shoqërisë, bëhet me përcaktimin e vlerës së tregut të paketës së aksioneve me ankand.

2. Me mbërritjen e urdhrin të *ministrit të Financave dhe Ekonomisë*, i cili shoqërohet edhe me listën e aksionarëve të shoqërisë dhe adresat përkatëse, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, fillon procedurat e privatizimit, sipas pikave 1 dhe 2 (pjesa hyrëse), të kreut II, dhe pikave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, të shkronjës “A”, të kreut II, të këtij vendimi, duke njoftuar aksionarët e shoqërisë për datën dhe orën e zhvillimit të ankandit.

3. Ofertë fituese shpallet pjesëmarrësi që deklaron çmimin më të lartë. Kjo ofertë u ofrohet aksionarëve të shoqërisë, të cilët duhet të japin pëlqimin për blerje ditën e zhvillimit të ankandit.

Nëse japin pëlqimin për blerje, për të filluar procedurat e privatizimit, aksionarët e shoqërisë duhet të paraqesin në strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, këto dokumente:

a) Kërkesën me shkrim, ku të shprehin pëlqimin për blerjen e pjesës së mbetur të aksioneve që u janë ofruar për blerje;

b) Pagesën paraprake, mandatarkëtimin, urdhërshirimin apo garancinë bankare në lekë për 30 përqindëshin e vlerës së pjesës së mbetur të aksioneve, që u janë ofruar për blerje në favor të *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*;

c) Një fotokopje të noterizuar të dokumentit identifikues.

4. Kur aksionarët e shoqërisë kanë plotësuar kërkesat e sipërpërmendura, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, lëshon autorizimin për kryerjen e pagesës së plotë të vlerës së pjesës së mbetur të aksioneve që u janë ofruar për blerje. Në autorizim përcaktohet se nëse aksionarët e shoqërisë nuk bëjnë pagesën e plotë të pjesës së mbetur të vlerës së aksioneve që u janë ofruar për blerje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e lëshimit të autorizimit, atëherë mbahet vlera e paguar paraprakisht prej tyre, 30 për qind, e cila kalon në favor të buxhetit të shtetit.

5. Kur aksionarët e shoqërisë, të cilëve u është ofruar për blerje paketa e aksioneve, nuk japin pëlqimin për blerje dhe nuk kryejnë pagesën përkatëse, atëherë vazhdojnë procedurat me pjesëmarrësin që ka ofruar çmimin më të lartë të paketës së aksioneve në ankandin e zhvilluar, duke lëshuar autorizimin përkatës për pagesën e vlerës së plotë të paketës së aksioneve.

Kjo pagesë duhet të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit nga *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*.

6. Kur pjesëmarrësi në ankand, i cili ka ofruar çmimin më të lartë të paketës së aksioneve, nuk kryen pagesën sipas paragrafit të dytë, të pikës 5, të shkronjës “C”, të kreut II, atëherë vlera prej 30 përqindësh, e parapaguar prej tij, mbahet si e ardhur në buxhet.

7. Në këtë rast, pjesa e mbetur e paketës së aksioneve u ofrohet pjesëmarrësve në ankand sipas radhës. Kur nuk ka oferta të tjera, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, bën edhe një publikim të dytë për shitjen e paketës së aksioneve, sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi. Në rast se edhe pas publikimit të dytë në ankand nuk paraqitet asnjë pjesëmarrës,

kjo drejtori njofton *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, e cila e vë këtë paketë në dispozicion të *Agjencisë së Trajtit të Pronës* për të kompensuar subjektet e shpronësuara.

8. Në shoqëritë tregtare me kapital 100 për qind shtetëror, ku trualli është futur në kapitalin e shoqërisë, të bëhet rivlerësimi i truallit sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, në kohën kur do të kryhet privatizimi, si pjesë e vlerësimit të shoqërisë.

9. Për shoqëritë pjesërisht të privatizuara, te të cilat nuk janë transferuar aksionet e ish-pronarëve të truallit, të kryhet transferimi i paketës para fillimit të procedurave për shitjen e paketës së aksioneve shtetërore. Pas transferimit të paketës së aksioneve të vazhdojë procedura e privatizimit sipas përcaktimeve në këtë vendim.

10. Në rastin kur kapitali themeltar i shoqërisë aksionare nuk ka ndryshim nga publikimi për privatizimin e shoqërisë, *Ministria e Financave dhe Ekonomisë* urdhëron transferimin e paketës së aksioneve në favor të ish-pronarëve të truallit (kur kjo procedurë nuk është realizuar), pa e shoqëruar me dokumentacion, sipas pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi.

### III. TË PËRGJITHSHME

1. Rezultatet përfundimtare të ankandit hartohen nga *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, në katër kopje, tre prej të cilave u përcillen:

- a) shoqërisë tregtare të privatizuar;
- b) *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*;
- c) Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

Kopja e katërt ruhet në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, *struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*.

2. Vlera e llogaritur e një aksioni caktohet e tillë që të zvogëlojë, në minimumin e mundshëm, efektet e rumbullakimeve të përqindjeve. Mbetjet e mundshme nga rumbullakimet kalojnë në llogaritë e shoqërisë, në zmadhim ose në zvogëlim të rezervës nga rivlerësimi.

3. *Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*, harton raportin përfundimtar për strukturën e pronësisë së aksioneve dhe materialin origjinal e dërgon në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*.

4. Lista e aksionarëve nuk publikohet. Çdo aksionar ka të drejtë të njihet me këtë listë pranë shoqërisë përkatëse dhe, në rast paqartësie, mund të kërkojë sqarime pranë *strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës*, në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*.

5. Gjatë periudhës pas ankandit deri në mbledhjen e parë të asamblesë është i ndaluar çdo emetim dytësor i aksioneve nga ana e shoqërisë.

6. Gjatë kësaj periudhe nuk lejohet asnjë strukturim i kapitalit ekzistues.

7. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe kryerjen e ndryshimeve përkatëse të statutit, këshilli mbikëqyrës dhe administratori apo administratorët do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre dhe do të mbajnë përgjegjësi të plotë për administrimin e pasurisë e të veprimtarisë së shoqërisë.

8. Deri në zgjedhjen e organeve të reja të shoqërisë së privatizuar dhe hyrjen në funksion të këtyre organeve, as shoqëria dhe as ndonjë organ tjetër nuk kanë të drejtë të kryejnë ose të autorizojnë kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:

- a) Shitjen e aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë;
- b) Kryerjen e investimeve të tjera, përveç atyre që kanë qenë kontraktuar më parë;
- c) Marrjen ose dhënien me qira të objekteve të ndryshme;
- ç) Marrjen e huave, përveç atyre që kanë qenë kontraktuar më parë, për nevoja rrjedhëse të veprimtarisë së shoqërisë;
- d) Çdo veprim tjetër, që do të sillte pakësimin e aktivitetit neto të shoqërisë.

Gjatë kësaj periudhe shoqëria nuk ka të drejtë, gjithashtu, të kryejë riorganizime, që sjellin shkurtime në numrin e punonjësve.

9. Shoqëria përgatit gjendjen financiare për periudhën nga çelja e ushtrimit deri në datën e fundit



të muajit kur është shpallur rezultati përfundimtar i ankandit, sipas akteve ligjore në fuqi.

10. Shoqëria shtetërore e privatizuar do të vazhdojë të mbartë të gjitha detyrimet, kreditore dhe debitore, të pasqyruara në bilancin e paraqitur të shoqërisë.

11. Vendimi nr.119, datë 18.3.2000, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar, dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij shfuqizohen.

12. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe *Ministria e Financave dhe Ekonomisë* të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e pikave 1, 2 dhe 3 (pjesa hyrëse), shkronjat “B”, “C”, Ç”, të kreut I, dhe pikat 1 dhe 2, shkronjat “A”, “B” dhe “C”, të kreut II, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**